

KONCESIONE / PARTNERITET **PUBLIK PRIVAT**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive Mabco Constructions SA of Matebex Group / NUIS: CHE – 101.624.994, YDA Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi / NUIS: 92203 dhe 2A Group sh.p.k. / NUIS: 810846800, me adresë: Via Cattori 7, CH-6900 Lugano – Paradiso, Switzerland / Zvicër.

Procedura konkurruese: Dhënia me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), me vendndodhje afër me zonën e Novoselës, në Akërnë, Vlorë.

Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 23.12.2019

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertuesit me vlerat përkatëse të ofruara:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive Mabco Constructions SA of Matebex Group / NUIS: CHE – 101.624.994, YDA Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi / NUIS: 92203 dhe 2A Group sh.p.k. / NUIS: 810846800, me vlerë investimi prej 104,310,500 Euro; dhe
- Shoqëria “AL-DE CORPORATION LIMITED” / NUIS: 9903242, nuk ka paraqitur ofertë.

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

Shoqëria “AL-DE CORPORATION LIMITED” / NUIS: 9903242

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertuesi ka paraqitur vetëm një dokument në platformën elektronike pranë APP, e identifikuar si Certifikatë Regjistrimi e Shoqërisë Private të Kufizuar, lëshuar nga Regjistri i Shoqërive për Anglinë dhe Welsin, e pa legalizuar si dokument dhe asnjë dokumentacion tjetër që kërkohet nga Dokumentat e kësaj Procedure Konkurruese. Si rrjedhojë, skualifikohet për mos plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit/kualifikimit sipas shtojcës nr. 9 të DPK.

* * *

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive Mabco Constructions SA of Matebex Group / NUIS: CHE – 101.624.994, YDA Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi / NUIS: 92203 dhe 2A Group sh.p.k. / NUIS: 810846800, me adresë: Via Cattori 7, CH-6900 Lugano – Paradiso, Switzerland / Zvicër, se oferta e paraqitur më datë 1 Shkurt 2021, për marrjen me koncesion/PPP, projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), është pranuar.

Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jetë 30 ditë nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive Mabco Constructions SA of Matebex Group / NUIS: CHE – 101.624.994, YDA Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi / NUIS: 92203 dhe 2A Group sh.p.k. / NUIS: 810846800 kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat e Procedurës Konkurruese, në vlerën e 5% e vlerës së projektit të propozuar. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 8.3.2021

Ankesa: Nuk ka